



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 760/3 Prot.

Tiranë, më 18/2013

**Lënda:** Rekomandim për farmaci "Agimi" Tiranë

**REKOMANDIM**

Nr. 13, datë 01/08/2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit ,

**KONSTATOVA**

Nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit farmaci "Agimi", Tiranë me objekt:

- Plotësimi i formularit te njoftimit (neni 21).
- Masat lidhur me sigurinë e te dhënave personale (neni 27).

Nga kontrollit administrativ u konstatua se:

Për kategorinë "klientë" gjatë aktivitetit të tij kontrolluesi mbledh recetat e tyre dhe i hedh ato brënda ditës online në faqen zyrtare të ISKSH-së për ilaçet e rimbursueshme.

Gjithashtu u konstatua se aktualisht në ambientet e farmacisë kamera nuk funksiononte por në një të ardhme ajo mund të vihet në funksion nga kontrolluesi për siguri të ambientit ku mbahen ilaçet.

Nga pyetjet që ju bën kontrolluesit u konstatua se aktualisht nuk ka rregulla të shkruara për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe kofidencialitetin e të dhënave personale të klientëve, si dhe të të dhënave të cilat do të përpunohen nga kontrolluesi nëpërmjet imazheve (CCTV).

U konstatua gjithashtu se kontrolluesi farmaci "Agimi" deri në momentin e dorëzimit të proces-verbalit nuk e kishte kryer detyrimin ligjor për të njoftuar pranë Komisionerit.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara vëren se:

- Kontrolluesi farmaci "Agimi" nuk ka një rregullore të shkruar për mbledhjen përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe kofidencialitetin e të dhënave personale të klientëve si dhe për imazhet video nëpërmjet sistemit (CCTV) në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 " Per mbrojtjen e të dhënave personale" si dhe udhëzimi nr. 3 dhe 13 Për "Sistemin e Video Survejimit në Ndërtesa, Lokale e Ambjente të Ndryshme".
- Nga kontrolli administrativ i ushtruar rezulton se kontrolluesi farmaci "Agimi" nuk e ka plotësuar detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në këto kushte vlerësoj se është shkelur ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", neni 27 dhe 28 i Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 " Per mbrojtjen e të dhënave personale" si dhe udhëzimi nr. 3 dhe 13 Për "Sistemin e Video Survejimit në Ndërtesa, Lokale e Ambjente të Ndryshme". Neni 21 pika 1 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Për sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

## **REKOMANDOJ**

- 1- Në zbatim të nenit 21 i Ligjit Nr. 9887 datë 10/03/2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" të përmbushi detyrimin ligjor për plotësimin e Formularit të njoftimit brënda 2 (dy) ditëve punë kalendarike.
- 2- Në zbatim të nenit 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe udhëzimi nr. 3 të Komisionerit "Për Sistemin e Video Survejimit në Ndërtesa, Lokale e Ambjente të Ndryshme", të merren masa për hartimin e një rregullore të shkruar për mbledhjen dhe përpunimin e imazheve video nëpërmjet sistemit të video vëzhgim-regjistrimit (CCTV), si dhe për mbledhjen përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe kofidencialitetin e të dhënave personale të klientëve.
- 3- Kryerja e këtij detyrimi të rëndësishëm të zbatohet brënda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh;
- 4- Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

- 5- Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

